



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJË**  
**SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE**

B.Curri me:18.01.2018

**SHPALLJE**

**POZICION TË LIRË PUNE NË SHËRBIMIN CIVIL PËR LËVIZJE PARALELE  
DHE NGRITJE NË DETYRË NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE**

**Përgjegjës i sektorit juridikë.**

Niveli i diplomës kërkuar Master shkencor në **Shkenca Juridike**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut I, II, III, dhe VII, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Tropojë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë e ulët e të mesme drejtuese , për pozicionin:

Përgjegjës sek. juridik dhe prokurimeve publike pozicion i lirë pune 1(një) , **kategoria III-a/1.**

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë vakante, atëherë janë të vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët drejtuese .Të dy procedurat (lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese ) aplikohen në të njëjtën kohë

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave për **LEVIZJE PARALELE: 29.01.2018 .**

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave për **PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 02.02.2018**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:**

- Përgjegjësi i sektorit juridik dhe prokurimeve publike përgjigjet para Kryetarit Bashkise për menaxhimin e çështjeve që lidhen me fushën e veprimtarisë së sektorit në përputhje me ligjet, aktet nënligjore apo aktet rregullatore në fuqi.
- Drejton dhe organizon punën e sektorit ku bën pjesë brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave;
- Organizon punën me vartësit për realizimin e detyrave në përputhje me politikat e institucionit , me standardet administrative dhe procedurat teknike, si dhe duke mbajtur parasysh praktikën më të mira profesionale;
- Planifikon dhe përmbush detyrat e ngarkuara në mënyrë profesionale dhe të pavarur;
- Identifikon mundësitë për përmirësimin e mëtejshëm të procedurave dhe teknikave të përdorura

në përmbushjen e detyrave.

- Përgatit në kohë dhe me cilësi materiale informuese për eprorët;
- Përgatit raporte periodike dhe informon eprorët për ecurinë e punës;
- Zbaton rekomandimet apo sugjerimet e eprorëve me qëllim përmirësimin e praktikave apo procedurave të zbatuara;
- Diskuton rezultatet e punës me eprorin dhe ja referon atij vetëm në rastet e çështjeve jo të zakonshme;
- Respekton të gjitha rregullat dhe dispozitat ligjore për dokumentimin, administrimin dhe ruajtjen e dokumenteve të bashkisë.
- Kryen detyrat që i caktohet nga Titullari i institucionit , gjithmonë në lidhje me fushën e veprimtarisë së sektorit ku bën pjesë
- Organizon punën brenda sektori dhe perfaqson institucioni në të gjitha proceset gjyqësore, civile dhe penale që kanë të bëjnë me institucionin e bashkisë.
- Në bashkëpunim me njësit e tjera përgatit kushtet kryesore teknike të thirrjes tenderave
- Organizon drejton dhe merret me procedurat e prokurimit .
- Organizon procesin e shqyrtimit dhe analizimit ofertave .
- Drejton dhe organizon punën për hartimin e kriterëve ligjore të kontratës përfundimtare
- Komunikon me fituesin e tenderit dhe monitoron realizimin e kontratës.
- Eshtë përgjegjës për dhënjen e këshillave,udhëzimeve dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore në fushën e prokurimeve publike,me qëllim zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi.
- Eshtë përgjegjës për kryerjen në kohë dhe me cilësi të inspektimit të dosjeve dhe raportimin për monitorimin e procedurave të monitorimit,në përputhje me legjislacionin.

**Për procedurën e lëvizjes paralele kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori (III-a/1), në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.**

### **KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mire”;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit Master shkencor në (shkenca juridike) edhe bachelori duhet të jetë kryer në shkenca Juridike.
- Të ketë eksperienc pune 5 vjet në profesion
- Te njoh programet bazë të kompjuterit

### **DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Tropojë, dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://administrata.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopjet e diplomës (Përfshi edhe bachelorin) Nëse studimet janë kryer jashtë vendit do duhet që diploma të sillet e njuhësuar nga Ministria e Arsimit dhe sporteve.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Tropojë, brenda datës **29.01.2018**.

## **REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **31.01.2018** njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Tropojë do të shpallë në stenden e informacionit Bashkise të institucionit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën paraprake për lëvizjen paralele të kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail) , ndërsa me dt. **08.02.2018** shpallet lista e verifikuar e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele si dhe datën, vendin e orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

## **FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

### **MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar. do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

### **Kandidatët do të vlerësohen me shkrim në lidhje me:**

- 1--Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;i ndryshuar
- 3-Ligji nr 139/2015 dt.17.12.2015’Per vetëqeverisjen vendore”
- 4-Ligji 7961 dt.12.07.1995 i ndryshuar Kodi i punes ne Repupliken e Shqipërise.
- 5- Kodi i procedurës civile
- 6-Kodi i procedurës administrative
- 7- Kodin e procedurës penal
- 8-Ligji nr 9643 dt.20.11.2006 “Per prokurimet publike”i ndryshuar
- 9-VKM nr 1 dt.10.01.2007 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar
- 10-Vkm nr.914 dt.29.12.2014 ”Për miratimin e rregulave të prokurimit publik i ndryshuar

## **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al” <http://administrata.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## **DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në stenden e informacionit të Bashkisë Tropojë dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” ndërsa konkurentet që nuk kualifikohen njoftohen në mënyrë elektronike nëpërmes e-mail-it.

### **2.-NGRITJA NË DETYRË NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE**

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në stenden e informacionit të Bashkisë Tropojë duke filluar nga data **08.02.2018**.

#### **2.1- KUSHTET E PERGJITHSHME QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët e nje kategorie më të ulët( IV-a), që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë në shërbimin civil janë:

- 1-Të jetë shtetas shqiptarë
- 2 - Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë IV-a
- 3 - Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- 4- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

#### **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- Të zotërojnë diplomën te nivelit Master shkencave ose te barasvlefshëm në Shkencat **juridike** (edhe Bachelori duhet të jetë përfunduar ne shkencat juridike).
- Të ketë eksperience pune në profesion, minimumi 5 vjet .

## **2.2- DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://administrata.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). Nëse studimet janë kryer jashtë shtetit duhet që të përcillet edhe njësimi i diplomes nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- Vetëdeklarim që nuk është përjashtuar me masë disiplinore nga shërbimi civil
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen pranë zyrës sekretarisë arkivit Bashkia Tropojë dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë e ulët drejtuese duhet të bëhet brenda datës **02.02.2018**

## **2.3- REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **12.02.2018** Bashkia Tropojë do të shpallë në Stenden e informacionit Bashkise Tropojë dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën paraprake të kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive,. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Tropoje, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail). Ndërsa me dt. **22.02.2018** shpallet lista e verifikuar e kandidateve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e posaçme për ngritjen në detyrë në shërbimin civil. gjithashtu në këtë date , njoftohen për vendin, datën dhe oren e konkurimit me shkrim dhe me gojë.

## **2.4- FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje**

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;i ndryshuar
- 3-Ligji nr 139/2015 dt.17.12.2015’per veteqeverisjen vendore”
- 4-Ligji 7961 dt.12.07.1995 i ndryshuar Kodi i punes ne Repupliken e Shqiperise.
- 5- Kodi I procedures civil
- 6-Kodi i procedures administrative
- 7- kodin i procedures penal
- 8-Ligji nr 9643 dt.20.11.2006 “Për prokurimet publike”i ndryshuar
- 9-VKM nr 1 , dt.10.01.2007 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar

10-VKM nr.914 , dt.29.12.2014 ”Per miratimin e rregulave te prokurimit publik i ndryshuar

### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

### **2.5 -MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar. për pervojen, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 20 pikë.

- Testimi me shkrim është 40 pikë
- Intervista e strukturuar me gojë është 40 pikë
- **Totali gjithësej i pikeve është 100 (njëqind)**

-Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al” <http://administrata.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

### **2.6- DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Nëpërmes portalit shërbimit kombëtar të Punësimit do të informoheni për datën e daljes së rezultateve përfundimtare .

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme Stenden e informacionit Bashkise Tropojë dhe “Portalin e shërbimit kombëtar të punësimit” duke filluar nga data **12.02.2018** e në vazhdim.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Tropojë do të shpallë fituesit në Stenden e informimit publik të Bashkise dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë që nuk shpallen fitues do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet e tyre (nëpërmjet adresës së e-mail).

**SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE**